



Ulvi Fejzullahu

Pas një selami të plotë, drejtori i shkollës së mesme në Bujanoc më drejtua me fjalët: mulla Ulvi ti kemi ndarë disa orë për mësimin fetarë, ju lutemi ejani deri në shkollë të bisedojmë për orarin. Të nesërmen shkova, drejtori më priti në zyrë, mi tha këto fjalë: mulla Ulvi kemi nevojë për një kuadër i cili na largon rininë nga dukurit negative, të punojmë së bashku që ta ruajmë te rinia nderin, moralin, etj..

Pas këtyre fjalëve të drejtorit, i cili kishte qëllim e dert Islamin e moralin, edhe unë ndërrova mendjen dhe u shpreha i gatshëm që rrogën që do ta e marr ta orientoj në bamirësi.

Pasi përfundoi, i thashë: zotni drejtor, faleminderit për besimin që keni ndaj meje, unë jam i gatshëm të kontribuoj me një gjysmë norme, sepse xhamia për mua është bazë. Por dua të di se si qëndron puna, a mundem unë të jap mësim sigurisht këtu, a jo!? Përgjigja ishte po, dhe s'ka çka me pas problem.

Mirë boll, kërkoj nga unë përzgjedhjen e ditëve. Zgjedha të martën dhe të mërkurën, dhe në praninë time e mori më telefon rregulluesin e orarit.

Ku më pas, emri figuroi në tabelën e orarit.

Por, por, unë ditarin në dorë asnjë herë nuk e mora.

Të nderuar, ky muhabet ka ndodhur para 5 – viteve.

Sigurisht që juve ju intereson të dini se kush nuk më lejoi mësimdhënien. Apo, kush lloboi që të më pengoi! Ju kërkoj falje por nuk do të merrem emra. Emrat me mbiemra janë të njohur, por neve kësaj radhe nuk po na interesojnë personat, por dukuria dhe fenomeni:

- pengesë,
- keqbërësi,
- urrejtje,
- zili.
- Etj....

Të nderuar! Më lejoni që një urim ta drejtoj në dy drejtime:

Për ata që deshën që unë të japë mësim, i uroj: Allahu ju shpërbleftë dhe faleminderit.

Për ata që më penguan nga mësimdhënia, edhe juve: Allahu ju shpërbleftë dhe faleminderit.

Të nderuar!

E vërteta është që në atë koha (para pesë viteve) u ngritën në këmbë disa prej hoxhallarëve dhe bënë pluhur, e etiketime prej ma të ndryshmëve. Sigurisht që nuk u ndjeva mirë, as unë po as xhemati i xhamisë. Tentuan të marrin disa iniciativa, por nuk i pëlqeva ato. Kështu që këtë punë ia ktheva Allahut të Lartësuar, dhe e bëra këtë dua:

O Allah, këtë zullum që e bënë këta “hoxhallarë” mos ma mundëso që unë të hakmerrem, sepse, unë, gjatë marrjes së hakut ose e teproj ose e lë pakë. O Allah, ti ia jep hakun çdo njerit.

Të nderuar!

Ashtu shkuan hesapet, ku të gjithë ata që shpifën, më akuzuan, më bënë padrejtësi, e më penguan Allahu i sprovoi. Nuk mbeti për ahiret, Allahu ia dha hakun në këtë dynja. Vitin e kaluar njërin prej atyre e larguan nga shkolla, ndërsa në këtë vit, asnjërit nuk i figuron emri në listë për mësimdhënie.

Të nderuar!

Nga kjo histori dëshiroj unë, fillimisht, të marrë mësim por kjo vlen edhe për ju. Kujdes, zullum e padrejtësi mos i bëni askujt, se këtë e korr edhe në dynja e lëre më për ahiret.

Të nderuar!

Mësimi fetarë nëpër shkollat tona në Luginë të Preshevës ka sjellë sukses, sikur të gjithë profesorët e lëndës fetare të jenë edhe më të përgjegjshëm do të jenë rezultatet edhe më të madha. Por, elhamdu lillah ka hajrë.

Këshilloj veten edhe profesorët e lëndës fetare me këto porosi:

- Keni frikë Allahun për fëmijët në shkollat fillore dhe të mesme, ata janë amanet.

- Bëjeni punën për Allahun duke kërkuar kënaqësinë e Tij.
- Respekt orarit të punës dhe jepjani hakun mësimi fetarë.
- Kujtoni se sikur kjo mirësi të keqpërdoret, Allahu mund të na sprovtoj, me largimin e lëndës fetare dhe zëvendësimin me atë qytetare.

Të nderuar mësimdhënës.

Respekt për ju, se jeni duke përcjell mesazhin Islam tek bijtë dhe bijat e këtij populli. Më ra në dorë lista e mësimdhënësve, pash emra që meritojnë respekt. Allahu ju ruajt juve dhe nxënësit tuaj. Allahu i faltë edhe ata që më bën zullum e nuk më lejuan të jap mësim, më vonë e kuptova hajrin dhe mirësinë në këtë.

Mbetshi të gjithë në kujdesin e Allahut të Lartësuar. Selamu alejkum.